

VENDIM
Nr.1317, datë 1.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË
STABILIZIM-ASOCIIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull periudha “2007-2012” zëvendësohet me “2008-2014”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2008-2014, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Integritit, në fillim të çdo muaji, për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas metodologjisë, që hartohet nga kjo ministri. Grupi ndërmintor i punës për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vlerëson dhe analizon, periodikisht, zbatimin e këtij plani.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha